

Zyra e shtypit
5 gusht 2010

Mbi ndërhyrjet në tregun e parasë dhe në tregun valutor gjatë tremujorit të parë të vitit 2010

1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË

Tabelë 1: Vëllimi i operacioneve të përkohshme të tregut të hapur

(në milionë lekë*).

DATA	R/REPO njëjavore me çmim fiks	R/REPO njëjavore me çmim variabël	R/REPO mujore	R/REPO tremujore
05.1.2010				
07.1.2010	19,070.00		3,000.00	
14.1.2010		15,010.00		5,000.00
21.1.2010		22,000.00		
28.1.2010		22,350.00		5,000.00
04.2.2010		17,930.00		
08.2.2010				3,000.00
11.2.2010		16,990.00		
18.2.2010		19,580.00		
25.2.2010		19,230.00		
04.3.2010		15,860.00		
11.3.2010		13,150.00		
18.3.2010		14,500.00		
25.3.2010		15,780.00		
31.3.2010				

1.1. Operacionet e tregut të hapur

Ndërhyrjet në tregun e parasë gjatë tremujorit të parë të vitit 2010 përfshijnë operacione të tregut të hapur për injektimin e likuiditetit.

Për të injektuar likuiditet, Banka e Shqipërisë përdori instrumentin e saj kryesor *marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor* mesatarisht 17.49 miliardë lekë* në javë si dhe instrumentet rregulluese me maturim më të gjatë se një javë - *marrëveshjen e riblerjes*

me maturim një dhe tre mujor. *Marrëveshja e anasjelltë e riblerjes me maturim njëmuajor* u përdor në një rast, mesatarisht 3.0 miliardë lekë. Edhe *marrëveshja e anasjelltë tremujore* u përdor në tre raste, mesatarisht 4.3 miliardë lekë për ankand. *


Përdorimi i instrumenteve mbështetëse

Gjatë tremujorit të parë të vitit 2010, depozita njëditore u përdor me një nivel mesatar ditor prej 0.35 miliardë lekësh, në krahasim me 0.54 miliardë lekë në ditë gjatë tremujorit të kaluar. Përdorimi i depozitës njëditore ishte më intensiv gjatë ditëve të fundit të periudhës së mbajtjes së rezervës së detyruar.

Instrumenti i kredisë njëditore gjeti një përdorim minimal gjatë këtij tremujori (një rast përdorimi në nivelin 10 milionë lekë).

Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë të përmbledhur ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë gjatë tremujorit të parë të vitit 2010.

Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë gjatë tremujorit të parë të vitit 2010 (me çmim blerjeje).



Burimi: Banka e Shqipërisë.

*Shifrat janë të shprehura në vlerë nominale.

2. NDËRHRYJET NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR

Veprime me bankat e nivelit të dytë

Në tremujorin e parë të vitit 2010, Banka e Shqipërisë nuk ka ndërhyrë në tregun e brendshëm valutor dhe nuk ka kryer veprime me bankat e nivelit të dytë.

Veprime me institucione të tjera

Gjatë kësaj periudhe kanë vijuar të realizohen veprime të shitjes dhe të blerjes së valutës me Ministrinë e Financave. Blerjet e valutës së Bankës së Shqipërisë nga Ministria e Financave gjatë kësaj periudhe shënuan 4.87 miliardë lekë, ndërsa shitjet 6.22 miliardë lekë.

Blerjet e valutës nga institucionet e huaja llogariten në 0.14 miliardë lekë (Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim – IDA dhe Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim - IBRD).

Institucioni financiar	Blerje të valutës (në milionë lekë)	Shitje të valutës (në milionë lekë)
MINISTRIA E FINANCIVE	4,869.6	6,215.5
TË TJERA (IDA, IBRD)	137.2	

Burimi: Banka e Shqipërisë.
